



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË
INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN”**

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për Ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati I Lumit Lana – Zhvillim Urban”.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin Zv. Ministra e Financave dhe përfaqësues të bashkisë Tiranë.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

- **Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

Ky projektligj ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, në shumën prej 2, 4 milionë eurosh. Vlera e grantit në shumën 2, 4 milionë euro do të shërbejë për bashkëfinancimin e projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, për të cilin Banka Evropiane e Investimeve akordon edhe një kredi në shumën 8 milionë euro.

Nisur nga plani i veprimit dhe i implementimit të këtij projekti, vlera, e cila do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, do të jetë e shpërndarë në 3 vite buxhetore, duke nisur nga viti buxhetor aktual. Kjo vlerë plotëson vlerën e grantit dhe të kredisë, me qëllim implementimin e projektit.

Projekti “Shtrati i Lumit Lana – Zhvillim Urban” mundëson krijimin e një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës.

Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij projektligji do të jenë Bashkia e Tiranës dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

- **Diskutimi në komision**

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin Zv. Ministria e Financave dhe përfaqësues të bashkisë Tiranë. Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit ndalën dhe diskutuan mbi objektivat dhe fazat e projektit. Deputetët kërkuar informacion lidhur me efektet financiare të projektligjit dhe garancitë që ofrojnë institucionet përgjegjëse për zbatimin e tij dhe pasi morën përgjigje nga përfaqësuesit e ministrisë vlerësuan nismën e propozuar dhe nevojën për përmbushjen e objektivave të këtij projekti.

Komisioni vlerësoi se **në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe **në aspektin procedural**, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim të diskutimeve, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATORE

EVIS KUSHI

KRYETARE

MIMI KODHELI